



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. i faq. 02
 Broj stranica 02
 Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-227/15
 Sr. Prot. Prot No 01-227/15
 Data 28-01-2015
 Datum Date 28-01-2015

PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	28/01/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Mirdit STRANA Drejtore Ekzekutiv – Spitali Rajonal “Dr.Sami HAXHIBEQIRI” - Mitrovicë
CC:	z. Zylfije HALILI, Menaxhere e Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e Spitalit Rajonal-Mitrovicë”



E nderuara znj. HALILI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e Spitalit Rajonal - Mitrovicë ” me numër prokurimi: 70600/14/052/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e Spitalit Rajonal - Mitrovicë” me numër prokurimi: 70600/14/052/111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Për rastin me nr. protokolli: DPKPP 03-03-152/15

Autoriteti Kontraktues Spitali Rajonal **“Dr.Sami HAXHIBEQIRI”** - Mitrovicë, bazuar në nevojën e tij për Furnizim me naftë dhe derivate të naftës ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur më datë: 09/12/2014. Kohëzgjatja e kontratës është paraparë në periudhë një vjeçare, shkurt 2015, shkurt 2016.

Agjencia Kundër Korrupsion është ftuar nga Autoriteti Kontraktues që të monitoroj punën e Komisionit Vlerësues për tenderin **“Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e Spitalit Rajonal – Mitrovicë”**. Më datë 22/01/2015 përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsion kanë marrë pjesë Komisionin e Vlerësimit dhe kanë konstatuar se vlerësimi i Ofertave ishte në përputhje të plotë me ligjin e Prokurimit Publik si dhe me Dosjen e Tenderit.

Agjencia Kundër Korrupsion, po ashtu ka konstatuar se gjatë përpilimit të dosjes së tenderit janë bërë disa formulime fjalish të cilat kanë lënë hapësirë për tu mos interpretuar vetëm në një mënyrë.

Në Dosja e Tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk i ka ndarë pozicionet në mes Naftës për Ngrohje dhe Naftës për Automjete. Një pozicion i tillë është dashur të bëhet, pasi çmimi i naftës si Lëndë djegëse, dallon prej çmimit të Naftës si derivat për Automjete. Po ashtu Autoriteti Kontraktues tek siguria e tenderit nuk ka kërkuar 3-5% të vlerës së parashikuar të kontratës, por ka mbetur në vlerën jashtë këtij kufizimi.

Shqetësuese për Agjencinë Kundër Korrupsion mbetet fakti që Operatorët Ekonomik ofertojnë me çmime **“Jo normalisht të ulëta”** me të cilat çmime është e pamundur të realizohet kontrata në tërësi. Në rastin konkret, çmimi i Ofruar *Premium/Litër* të derivateve, nuk i mbulon as shpenzimet e transportit të sjelljes së derivateve deri tek autoriteti Kontraktues.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron që në Dosjen e Tenderit është dashur edhe më në detaje të qartësohen kërkesat, në mënyrë që mos të lihet hapësirë që vlerësimi të vështirësohet.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit dhe Nenin 57 Sigurimi i Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët furnizues ose furnizuesit potencial.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !